

CILAT JANË DETYRAT E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI?

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbështet njerëzit që përballen me diskriminimin. Komisioneri mund:

- të shqyrtojë ankesat dhe të vendosë sanksione ndaj personave që diskriminojnë të tjerët
- të informojë njerëzit rreth të drejtave të tyre
- të ndihmojë njerëzit që të gëzojnë të drejtat e tyre për barazi dhe mbrojtje nga diskriminimi
- të publikojë raporte dhe të bëjë rekomandime mbi çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin

KUSH KA TË DREJTË T'I DREJTOHET KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI?

Kushdo që beson se është diskriminuar, që mendon se dikush tjetër është diskriminuar, apo që dëshiron të bëjë pyetje në lidhje me diskriminimin mund t'i drejtohet Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

SI MUND TA KONTAKTOJ KOMISIONERIN PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI?

Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi mund ta

kontaktoni duke telefonuar, duke dërguar një letër apo një faks – ose duke plotësuar formularin që gjendet në faqen e internetit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në adresën www.kmd.al
Mund të lini, gjithashtu, edhe një takim me zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për një bisedë personale.

ADRESA:

Rr: Sami Frashëri, Nr 10, Kati II, Tiranë

Kutia postare 1019


Telefon: + 355 4 243 1078

Faks: + 355 4 243 1077

E-mail: info@kmd.al

web: www.kmd.al

Harta



Tiranë 2011

LIGJI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

OSCE

Prezenca në Shqipëri

Më datë 13 mars 2010 ka hyrë në fuqi **Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi**. Ky ligj ka për qëllim të parandalojë dhe të ndalojë diskriminimin. Ligji përcakton gjithashtu pasoja ligjore në rastet e diskriminimit dhe parashikon mekanizmat për ndjekjen e ankesave.

Për të garantuar një mbrojtje të efektshme nga diskriminimi, Ligji parashikon ngritjen e zyrës së **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi** si një organ i pavarur barazie me qendër në Tiranë.

E DREJTA PËR BARAZI DHE MOSDISKRIMINIM

E drejta për barazi dhe mosdiskriminim do të thotë se askush nuk duhet të diskriminohet për shkak të dallimeve si raca, seksi, besimi fetar, bindja politike, aftësia e kufizuar, orientimi seksual apo për shkak të çfarëdolloj statusi tjetër. Ajo do të thotë gjithashtu se çdo person duhet të ketë mundësi të gëzojë të drejtat e tij apo të saj themelore të njeriut në mënyrë të barabartë me të tjerët dhe se individit duhet të mbrohet nga diskriminimi përmes ligjeve dhe politikave të efektshme.

E drejta për barazi dhe mosdiskriminim nuk ndalon trajtimin e ndryshëm. Vetëm trajtimi i ndryshëm i

pajustificuar quhet diskriminim dhe si i tillë është i ndaluar.

Diskriminimi ndodh në forma të ndryshme. Kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme apo nëse do të trajtohej në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër në një situatë të ngjashme, kemi të bëjmë me **diskriminim të drejtpërdrejtë**. I tillë është, për shembull, rasti kur një grua paguhet më pak sesa një kolegu i saj për të njëjtën punë.

Diskriminim i tërthortë ose jo i drejtpërdrejtë është ai lloj diskriminimi që ndodh kur trajtimi në dukje është neutral, por ka pasoja të pafavorshme për persona të caktuar. Megjithatë, ky lloj diskriminimi është i ndaluar vetëm kur ky trajtim ose nuk justifikohet objektivisht me një qëllim legjitim, ose kur mjetet për arritjen e atij qëllimi janë ose të papërshtatshme ose të panevojshme.

Për shembull, nëse një dyqan nuk i lejon përgjithësisht qentë të futen brenda (praktikë neutrale) dhe për rrjedhojë nuk e lejon as një person të verbër që të hyjë në dyqan bashkë me qenin e tij shoqëruar, ky konsiderohet diskriminim i tërthortë, pasi ai ka një pasojë të dëmshme ndaj këtij personi, e cila nuk mund të justifikohet. Një shembull tjetër diskriminimi i tërthortë do të ishte rasti i një punëdhënësi që kërkon përvojë të pandërprerë pune nga çdo person (kriter neutral). Megjithatë, ky kriter neutral do të kishte një pasojë të pafavorshme për gratë, të cilat kanë më shumë gjasa që të marrin leje si prindër.

Ngacmim është ajo sjellje e padëshiruar që ka si pasojë

apo si qëllim cenimin e dinjitetit të një personi tjetër. Shembuj ngacmimi janë: rastet kur burrat bëjnë komente me nënkuptime në prani të një gruaje – apo kur dikush bëhet objekt talljesh në vendin e punës pasi kolegët e tij zbulojnë se ai është homoseksual.

Diskriminim është edhe **mohimi i akomodimit të arsyeshëm** të personave me aftësi të kufizuara, kur atyre u duhet një modifikim në mënyrë që të gëzojnë të drejtat e tyre si të tjerët.

Do të ishte diskriminim, për shembull, nëse një punonjës i ri që përdor karrige me rrota e njofton punëdhënësin se karrigia e tij nuk përshtatet me tavolinën e tij të punës dhe punëdhënësi nuk pranon që t'ia ndërrojë tavolinën me një tjetër që përshtatet me karrigen e tij me rrota.

NË CILAT FUSHA OFRON MBROJTJE LIGJI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI?

Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi ofron mbrojtje për personat e diskriminuar **për shkaqe të ndryshme**, duke përfshirë diskriminimin për shkak të origjinës etnike, përkatësisë gjinore, besimit fetar, aftësisë së kufizuar, moshës apo orientimit seksual në çfarëdolloj fushe të jetës private dhe publike. Kështu, ai fokusohet tek mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit, arsimit, si dhe në fushën e mallrave dhe shërbimeve.